

# Lindur për të lexuar

© TUTTI I DIRITTI RISERVATI

## Si bëhet leximi i librave me fëmijë tuaj

- zgjidhni një vend të përshtatshëm ku të uleni dhe mbajeni fëmijën në krahe
- recitoni ose këndonni përallat e librit tuaj të parapëlqyer
- përpikuni të mënjaroni burimet e tjera të tërheqjes së vëmendjes - televizion, radio, stereo
- mbani librin në dorë në mënyrë që fëmija juaj mund të shikojë faqet qartë
- bëjeni të tregojë figurat
- flisni për figurat dhe përsëritni fjalët me përdorim të përditshëm
- lexoni së bashku, krijoni zërat e personazheve dhe përdorni mimikën për të treguar përallën
- ndryshoni ritmin e leximit - më ngadalë ose më shpejt
- bëni pyetje: ç'farë mendon se do të ndodhë tani?
- lereni fëmijën të bëjë pyetje dhe kapni rastin për të folur
- bëjeni fëmijën të tregojë vetë përallën
- ipni mundësinë fëmijës tuaj të zgjedhë vetë librat
- rilexon librat e tij të parapëlqyer edhe në se e kërkon shpesh

## Ç'farë librash zgjidhen

- kërkonte bibliotekës listën e librave më të bukur e "të kolauduar"
- vendosni në dhomën e tij ose në llibrarinë tuaj një plan, i arritshëm nga fëmija, për librat e vet. Me kohë do të formohet biblioteka e tij vetjake
- nganjëherë, në se është e mundur nji herë në muaj, shkoni në bibliotekë ose librari: do të habiteni me zgjedhjet e tiji

## Dhe kujtoni

- në se ju pëlqen leximi, fëmija do ta ndjejë dhe do ta pëlqejë dhe ai
- vini në dispozicion të fëmijës tuaj sa më shumë libra të jetë e mundur
- krijoni zakonin e vajtes në bibliotekë dhe librari së bashku me fëmijën tuaj
- leximi me fëmijën tuaj e ndihmon atë të rritet si individ

### Nati per Leggere

Versione in albanese

Con il patrocinio del  
Ministero per i Beni e le Attività Culturali

Associazione Italiana Biblioteche  
Associazione Culturale Pediatri  
Centro per la Salute del Bambino

[npl@aiib.it](mailto:npl@aiib.it)

[www.natiperleggere.it](http://www.natiperleggere.it)

Sostieni il progetto con il 5 per mille  
Codice fiscale 00965900327

## Projekt për lexim për fëmijë prej vitit të parë të jetës



### Fëmija, zhvillimi i tij dhe librat

A është e mundur të njihesh me librin para se të dish të lexosh? Shumë të rritur janë të bindur se jo! Përkundrazi, në se personaliteti dhe zhvillimi i çdo fëmije janë shumë të ndryshëm, librat dhe leximi, të dhëna me kujdes dhe herët, mund të bëhen shokë dhe miq besnikë të pandarë të rritjes.

Këto të dhëna të shkurtëra mund të jenë të dobishme për të ndjekur etapat e afrimit të fëmijës tuaj të librit dhe leximi. Pediatri juaj do t'ju shpjegojë këto gjatë vizitës së kontrollit në vitet e para të jetës dhe do t'ju sqarojë dyshimet e mundëshme. Biblioteka do t'ju ndihmojë për të zgjedhur librat dhe do t'ju a verë në dispozicion me huazim titujt më të mirë.

### Fëmijë i muajit të parë

I pëlqejnë nina-nanat e në pak kohë mësohet me to. Mund të njohë nina-nanat familjare dhe në dialektin apo gjuhën e praradhtjes.

### Fëmijë 6 muajsh

të rriqet nga fotot dhe figurat e librit që kërkon ti marrë dhe "ti hajë". Librat duhet të jenë të fortë, jo helmues, me faqe të mëdha e të trasha, me ngjyra të gjalla dhe sende familjare ose figura fëmijësh, me pamje të thjeshta e të qarta.

### Fëmijë 12 muajsh

i ndihmuar mban librin në dorë dhe shfleton shumë faqe njëherësh. I jep librin të rriturit. Më të përshtatshëm e të përdorshëm janë librat prej kartoni. Figurat e parapëlqyera janë ato që pasqyrojnë jetën e përditëshme (të ngrënit, gjumin, lodrat).

### Fëmijë 15 muajsh

shfleton faqe të mëdha me dy gishta. Në rastet kur libri ka një faqe, e kupton në se e përmbys. I pëlqejnë librat me fjali të shkurtëra e të lehta, që mund ti mësojë e paraprijë.

### Fëmijë 18 muajsh

plotëson dhe paraprin frazat e librit. I pëlqejnë librat që flasin për kafshët, fëmijët, gjërat e përditëshme, me fjali të shkurtëra e të thjeshta.

### Fëmijë 24 muajsh

shfleton mirë faqet. E merr librin nëpër shtëpi dhe "u lexon" kukullave ose maces duke shpikur vetë histori sipas pëlqimit të vet. I pëlqen të njehsohet me personazhet.

### Fëmijë 30 muajsh

i pëlqejnë tregimet me fëmijë të moshës së vet në të cilët fliet për çaste të jetës së përditëshme, miqësitë, mbi vellezërit e motrat, por tashmë vlerëson dhe librat me fantazi, aventura dhe përralla tradicionale. Provat duhet të jenë të thjeshta. Fëmijës i pëlqen të zgjedhë tregimin dhe ta dëgjojë atë shumë herë.

Fëmija në rritje fiton pavarësinë në zgjedhjen e librave dhe një shkathësi më të madhe në lexim, por gjithmonë është i kënaqur në se prindërit i lexojnë me zë të lartë, madje dhe kur fillon shkollën dhe lexon vetë.

## Këshilla dhe të dhëna për prindërit për leximin me zë të lartë

### Leximi me zë të lartë

- krijon zakonin e të dëgjuarit
- shton kohën e vëmendjes
- shton dëshirën e të mësuarit nëpërmjet leximit
- është një përvojë shumë e këndëshme për të rriturin dhe fëmijën
- qetëson, siguron dhe ngushëllon
- forcon lidhjet shpirtërore ndërmjet lexuesit dhe dëgjuesit

### Kur duhet të lexoni me fëmijët tuaj

- mund ti rezervoni leximit një çast të veçantë të ditës - para gjumit ose gjatë përkundjes, pas ushqimit, ndoshta duke zgjedhur çastet gjatë të cilëve jeni të dy më të qetë
- mos këmbëngulni në se fëmija është i shqetësuar dhe jo i qetë
- përfitonin nga çastet e pritjes - gjatë një udhëtimi, te mjeku
- leximi duhet të bëhet te fëmija juaj dhe kur është i sëmurë